



Prishtinë, 27 nëntor 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1196\_2019

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 16 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V\_981\_2018 të datës 13 qershor 2018 lëshuar shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin "Wind Park –SELAC 2" me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW, ZK Kaqandollë dhe Bajgorë, komuna e Mitrovicës; dhe
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_981\_2018 të datës 13 qershor 2018 i Modifikuar me vendimin V\_1165\_2019 të datës 10 korrik 2019 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës (Wind Park –SELAC 2) me kapacitet të instaluar prej 34.47 MW ZK Kaqandollë dhe Bajgorë, komuna e Mitrovicës, të datës 30.09.2019 të shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., me adresë rruga "Mujo Ulqinaku" nr. 12 Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 27 nëntor 2019 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., dhe **SHTYHET afati i vlefshmërisë së VENDIMIT TË AUTORIZIMIT FINAL V\_981\_2018** i datës 13 qershor 2018, i Modifikuar me Vendimin V\_1165\_2019 të datës 10 korrik 2019 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës (Wind Park –SELAC 2) me kapacitet të instaluar prej 34.47 MW ZK Kaqandollë dhe Bajgorë, komuna e Mitrovicës, edhe për 2 (dy) vite, gjegjësisht deri **me 13 qershor 2022 për finalizimin e projektit.**

## A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 14.07.2013 nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, në lokacionin "Wind Park – SELAC 2", komuna e Mitrovicës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga ERA, me datë 25 nëntor 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_866\_2016, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.



- o ZRRE me datë 06.11.2017 ka pranuar nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_866\_2016 të datës 25 nëntor 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, për të kompletuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit Final.
- o ZRRE me datë 29 mars 2018 ka lëshuar vendimin nr. V\_941\_2018 për shtyrjen e vlefshmërisë së afatit të vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_866\_2016 të datës 25 nëntor 2016, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 25 maj 2018.
- o ZRRE me datë 25.05.2018 nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin "Wind Park – SELAC 2", me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW komuna e Mitrovicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga MMPH dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- o ZRRE me datë 13 qershor 2018 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V\_981\_2018 shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Turbinat e Erës në Lokacionin "Wind Park –SELAC 2" me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW, ZK Kaqandoll dhe Bajgorë, komuna e Mitrovicës.
- o ZRRE me datë 03 qershor 2019 nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final për Modifikimin e Turbinave të Erës nga 10 turbina sa ishin të Autorizuara në 9 Turbina, dhe kapaciteti i instaluar prej 34.47 MW ZK Kaqandoll dhe Bajgorë, Komuna e Mitrovicës.
- o ZRRE me datë 10 korrik 2019 ka lëshuar Vendimin për Modifikimin e Autorizimit Final V\_1165\_2019 me të cilën ka aprovuar kërkesën e shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., për Modifikimin e Autorizimit Final V\_981\_2018 të datës 13 qershor 2018, nga 10 (dhjetë) turbina të Erës sa ishin të autorizuara fillimisht në reduktimin numrit të tyre në 9 (Nëntë) Turbina të Erës dhe kapaciteti i instaluar prej 34.47 MW ZK Kaqandoll dhe Bajgorë, Komuna e Mitrovicës.
- o ZRRE me datë 30 shtator 2019 nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V\_981\_2018 të datës 13 qershor 2018, të Modifikuar me Vendimin V\_1165\_2019 për projektin Wind Park – SELAC 2, me kapacitet të instaluar prej 34.47 MW ZK Kaqandoll dhe Bajgorë, Komuna e Mitrovicës, **për finalizimin e projektit edhe për 2 (dy) vite, gjegjësisht deri me 13 qershor 2022.**
- o Shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., në kërkesën e saj ka sqaruar se: *edhe përkundër vështirësive gjatë kësaj kohe është bërë një progres i dukshëm në realizimin e punimeve në ndërtimin e parkut të erës. Arsyeja e kërkesës për shtyrje të vlefshmërisë së autorizimit për ndërtimin e parkut të erës është se, edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të përfunduar realizimin e këtij projekti me interes, nuk ka mundur të realizohet brenda këtij afati fillestar të caktuar nga Bordi i ZRRE-së, për shkak të pengesave, vështirësive teknike të lokacionit dhe faktit se ka pasur vështirësi dhe vonesa në sigurimin e mjeteve financiare për realizimin e projektit.*
- o Projekti i SOWI KOSOVO L.L.C., është një projekt gjenerimi në shkallë të gjerë në një lokacion specifik dhe të vështirë (përfshirë terrenin malor, 1500 m mbi nivelin e detit, hyrje të vështirë, kushte të rënda klimatike etj.), me një linjë rrjeti në distancë të gjatë që duhet të ndërtohet dhe kufizime të motit në periudhat se kur mund të punojmë në ndërtimin (vetëm për disa muaj gjatë verës dhe një pjesë të pranverës dhe vjeshtës). Për më tepër kompleksiteti i kërkesave të lejeve



*të ndryshme (për të drejtat e tokës, për mbrojtje e mjedisit, me leje të shumta ndërtimi) dhe procesi i shpronësimit për linjat e lidhjes në rrjet kanë ndikuar ndjeshëm në kohën e nevojshme për të përfunduar zhvillimin e plotë të Projektit SELAC 2.*

- o Po ashtu duke marr parasysh edhe kërkesën e prodhuesit të turbinave, është dashur që të fillojmë procesin e modifikimit të autorizimit final, ku përsëri është dashur të kalohet nëpër një proces të gjatë deri të marrja e vendimit për ndryshimin e lejes ndërtimore nga MMPH, dhe vetëm pas këtij procesi më në fund është arritur të marrin aprovim nga Bordi i ZRRE-së, ku me datë 10 korrik 2019 është lejuar Modifikimi i Autorizimit Final për kapacitetin e instaluar me vendimin V\_1165\_2019.*
- o Po ashtu kanë sqaruar dhe duke pasur parasysh edhe diskutimet e ZRRE-së, me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), tashmë kanë informuar se kompania SOWI KOSOVO L.L.C., ka nënshkruar edhe Marrëveshjen për Blerje të Energjisë (MBE) me KOSTT, ku me nënshkrimin e MBE-së, e cila tanimë është pranuar edhe nga BERZH, kanë mbetur vetëm pak hapa para se të arrijnë të përmbyllin marrëveshjen e parë financiare në Kosovë, e cila garantohet vetëm me MBE për të kryer financimin e projektit. Financimi i projekteve përmes kredisë nga BERZH është në fazën finale të aprovimeve nga organet drejtuese të BERZH-it.*
- o Po ashtu kanë sqaruar se tani më janë kualifikuar edhe me statusin e Investitorit Strategjik, dhe gjatë procesit të aplikimit për investime strategjike, ZRRE-ja ka njoftuar komisionin për investime strategjike të themeluar nga Qeveria e Kosovës, kompaninë Sowi dhe BERZH-in, se nuk ka pasur ndonjë rast të refuzimit të ZRRE-së, për vazhdimet e afateve ligjore të përcaktuara nga Rregulla për procedurën e autorizimit, dhe arsyeja kryesore e kësaj kërkesë është që tani, para shqyrtimit final të BERZH-it, për financimin e kredisë, e cila pritet të përfundoj në dhjetor të këtij viti (2019), që të mundohet shtyrja e këtij afati të autorizimit final për dy (2) vite, deri me 13 qershor 2022, pasi që pranimi i kësaj shtyrje është parakusht për financimin, pasi që siguron që miratimet rregullatore pranojnë afatin kohor të zbatimit të projektit.*
- o Andaj, bazuar në të gjitha ato që u paraqitën më lartë, i kërkojnë Bordit të ZRRE-së, që duke u mbështetur në dispozitat ligjore të Nenit 16 paragrafi 4 (për mundësi shtyrje për një periudhë një vjeçare), si dhe paragrafin 5 (për mundësi shtyrje për një periudhë shtesë një vjeçare), të Rregullës së procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, që të aprovohet kërkesa për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit për Autorizimin Final V\_981\_2018 të datës 13 qershor 2018, për vazhdimin e ndërtimit edhe për dy (2) vite, në mënyrë që të arrihet të përfundohet ky projekt i rëndësishëm për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtitshme. Ndërsa sipas planit dinamik të projektit priten të gjitha punimet të realizohen deri me 13 qershor 2022.*
- o Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., dhe dëshmime të bashkangjitura, për shtyrje të Autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era Wind Park – SELAC 2, me kapacitet të instaluar prej 34.47 MW, ka vlerësuar ato, dhe ka konstatuar se kërkesa është e bazuar, duke u vlerësuar edhe kërkesën e BERZH, se shtyrja e afatit të autorizimit Final është parakusht për financimin e projektit, dhe poashtu duke pasur parasysh se ndërtimi i këtyre kapaciteteve është mjaft i vështirë për shkak të terreneve, kushteve klimatike dhe kompleksitetit të këtyre projekteve, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.*


II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. kryesues

  
Besim Selçija, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Mitrovicës
- Sekretarit të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.